

NR 02/115

MARRËVESHJE BASHKËPUNIM

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO	REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E SHITES/OPSTINA STIMLJE	KOMUNA E SHITES/OPSTINA STIMLJE
Nr. Prot./Br. Prot. <u>02/116</u>	
Nr. Faqeve/Br. Strana <u>5</u>	
Data/Dana/ <u>19.04.2022</u>	
SHITES/STIMLJE	

E lidhur më 19 / 04 / 2022, në Prishtinë, në mes të:

“KOMUNËS SË SHITES”, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. Qemajl Aliu, tash e tutje referuar si “KOMUNA”

DHE

“FONDACIONIT PËR TË DREJTAT E KAFSHËVE”, me numër të regjistrimit të OJQ-së 5200423-3, me seli në adresën rr. “Rexhep Luci”, Nr.8/9, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga znj. Elza Ramadani, Drejtoreshë Menaxhuese, tash e tutje referuar si “FONDACIONI”,

Së bashku referuar si “Palët”.

DUKE QENË SE KOMUNA si autoritet komunal i Republikës së Kosovës ndër të tjera zbaton edhe legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve shoqëruese dhe ato endacake.

DUKE QENË SE FONDACIONI është një organizatë joqeveritare ku si qëllim kryesor të veprimtarisë ka ndër të tjera përmirësimin e mirëqenies së kafshëve.

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Qëllimi kësaj marrëveshje bashkëpunimi përfshin, por nuk kufizohet në monitorimin e projekteve që janë në zhvillim e sipër apo projekteve që mund të fillojnë në të ardhmen, të cilat zhvillohen apo udhëhiqen nga KOMUNA, që kanë të bëjnë me mirëqenien e kafshëve shoqëruese dhe endacake në territorin e Komunës.
2. Me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje palët obligohen që të bashkëpunojnë në mirëbesim dhe të asistojnë njëra tjetrën për aq sa është e mundur, në rastet kur konstatohet se mirëqenia e kafshëve është duke u cenuar.

Neni 2

Financat

Për nënshkrim e kësaj marrëveshje, asnjë kosto financiare nuk do të iu ngarkohet Palëve. Marrëveshja lidhet vullnetarisht nga Palët.

Neni 3

Obligimet e KOMUNËS

KOMUNA merr përsipër që:

1. Të autorizojë Fondacionin si entitet monitorues në projektet të cilat janë në zhvillim e sipër apo ato të cilat mund të fillojnë në të ardhmen pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, që kanë të bëjnë me mirëqenien e kafshëve shoqëruese dhe endacake.
2. T'i ofrojë Fondacionit qasje në të gjitha dokumentet, informatat dhe materialet e nevojshme për çdo projekt që është në zhvillim e sipër dhe ato të cilat mund të fillojnë në të ardhmen pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien e kafshëve shoqëruese dhe endacake, për aq kohë sa kjo marrëveshje është në fuqi.
3. Të ftojë Fondacionin në takime zyrtare të cilat kanë të bëjnë me projektet sa i përket mirëqenies së kafshëve shoqëruese dhe endacake.
4. T'i lejojë Fondacionit qasje në të gjitha objektet që mbahen kafshët shoqëruese dhe endacake nëse dyshohet për shkelje të mirëqenies së kafshëve apo kurdo që Fondacioni vlerëson si të arsyeshme vizitën monitoruese.
 - 4.1. Objektet e mbajtjes së kafshëve shoqëruese dhe endacake vlerësohen sipas këtij memorandumi, si më poshtë:
 - a. Të gjitha strehimoret e kafshëve shoqëruese dhe endacake;

- b. Mbarështuesit e kafshëve shoqëruese;
- c. Pet shopet (dyqanet e kafshëve);
- d. Qendrat për Trajtim të Përkohshëm të licencuara dhe ato ende jo të licencuara nga AUVK;
- e. Subjektet veterinarë në rast se strehojnë apo mjekojnë kafshë shoqëruese dhe/ose endacake në kuadër të projekteve publike të kontraktuara me tender publik, të hapur.

Neni 4

Obligimet e FONDACIONIT

FONDACIONI merr përsipër dhe obligohet që:

1. Të asistojë KOMUNËN, në mundësitë e disponueshme, në projektet të cilat janë në zhvillim e sipër dhe projektet të cilat mund të fillojnë në të ardhmen pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje.
2. Të asistojë KOMUNËN, në mundësitë e disponueshme, në propozimin e rregulloreve komunale sa i përket përmirësimit të mirëqenies së kafshëve shoqëruese dhe/ose endacake në Komunë e Shtimes.
3. Të angazhohet në aktivitete monitoruese dhe të njoftojë KOMUNËN në rastet kur konstaton nga terreni se është duke u cenuar mirëqenia e kafshëve.
4. Dokumentet, informatat dhe materialet të cilat i pranon nga KOMUNA, t'i mbajë në konfidencialitet të plotë nga palët e treta dhe nga publiku.
 - 4.1 Përfundimisht FONDACIONI të njëjtat mund t'i bëjë publike vetëm në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga një organ shtetëror apo një gjë e tillë është në mbrojtje të interesit publik.
 - 4.2 Përfundimisht, FONDACIONI mund t'i bëjë publike raportet e punës në kuadër të projekteve publike të kontraktuara me tender publik të hapur.
5. Fondacioni është i obliguar që të raportojë tek KOMUNA për çdo vizitë monitoruese që bën në territorin e komunës së Shtimes, me foto-dokumentime apo çfarëdo raportit që vlerësohet si i nevojshëm nga KOMUNA.

Neni 5

Kohëzgjatja

1. Ky Memorandum do të jetë i vlefshëm për një periudhë dy (2) vjeçare nga momenti i nënshkrimit.
2. Kjo marrëveshje konsiderohet efektive në momentin e nënshkrimit të saj.
3. Secila nga palët mund të shkëpusë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme në rast se i dërgon njoftim me shkrim palës tjetër në një afat prej 30 ditësh.

Neni 6

Konfliktet

1. Është rënë dakord që, se çdoherë që del një kontest nga kjo marrëveshje, palët të zgjidhin atë me pajtim të ndërsjellë.
2. Nëse palët nuk mund të arrijnë një zgjidhje brenda afatit prej 30 ditësh, atëherë kontesti do të zgjidhet nga Gjykata kompetente.

Neni 7

Ligji i aplikueshëm

Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë marrëveshje duke përfshirë interpretimin e saj, aplikimin, vlefshmërinë, performancën dhe shkeljet, do të zbatohen në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës.

Neni 8

Marrëveshja e plotë dhe Amandamenti

1. Ky dokument përmban marrëveshjen e plotë në mes të palëve.
2. Asnjë amandamentim, ndryshim, modifikim, ose shtesë e kësaj marrëveshje nuk do të jetë e vlefshme ose e detyrueshme nëse nuk shprehet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

Neni 9

Ekzekutimi i Marrëveshjes

Kjo Kontratë do të ekzekutohet në dy (2) kopje identike në gjuhën shqipe, dhe çdo kopje do të konsiderohet si origjinal i Marrëveshjes.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Kontratë hyn në fuqi më 19/04/2022

SI DËSHMI E KËSAJ, palët kanë vendosur nënshkrimet e tyre dhe vulat në ditën dhe vitin e shkruar më lart.

PALËT NËNSHKRUESE:

FONDACIONI



Znj. Elza Ramadani

Drejtoreshë Ekzekutive



Z. Qemajl Aliu

Kryetar